

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Shofer

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtitimit te Kredive dhe rregullores se saj

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;

Përgjegjësitë

Detyrat e *Shoferit*:

- Është në varësi të Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.
- I ndalohet në mënyrë kategorike përdorimi i alkolit gjatë orarit të punës ose kur është në shërbim.
- Drejtuesi i mjetit (shoferi) merr urdhëra shërbimi nga Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse
- Merr në dorëzim me proces-verbal mjetin në përdorim nga specialisti përgjegjës për magazinën, dhe Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, ku shënohet gjëndja teknike e mjetit në momentin e marrjes në dorëzim, gjëndjen e aggregateve, riparimet e fundit, inventarin e imët dhe kilometrazhin e përshkuar.
- Paiset me dokumentacionin për drejtimin e mjetit si autorizimin vjetor nga Drejtori i Përgjithshëm, akt-kolaudimin, lejen e qarkullimit, siguracionet, etj. dhe lajmëron Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse për afatin ligjor të përfundimit të këtyre dokumentave.
- Mban pastër mjetin, kryhen shërbimet teknike, nënshkruan për sasinë e vajit dhe karburantit që merr. Nuk lejohet të tejkalojë normativën e karburantit.
- Kur automjeti është në Tiranë detyrohet të parkojë mjetin në parkingun e caktuar nga ATK-ja, ndërsa kur ndodhet me shërbim jashtë Tiranës, nuk duhet të largohet pa siguruar mjetin.
- Në datën 30/31 të çdo muaji, i dorëzon Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, autorizimet dhe fletë udhëtimit mujore.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjencia e Trajtimit të Kredive

Njësia Administrative nr.13, Selitë - Tiranë Rruga “Rrapo Hekali”, Ndërtesa 21. Kodi 2084021

Afati

Aplikimet pranohen deri në datën 14 Tetor 2022 , ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.